


PHILIPS

Boks me valë
për shtëpi

TAW6205

Manuali i përdorimit



Regjistroni produktin dhe merrni ndihmë në:
www.philips.com/support

Përmbajtja

8	Zgjidhja e problemeve	16
9	Njoftim	18

1	E rëndësishme	3
	Siguria	3
	Ndihmë dhe mbështetje	3
2	Boksi juaj me valë	4
	Çfarë ka në kuti	4
	Përmbledhje për boksen	4
3	Fillimi	6
	Lidhja e energjisë	6
	Ndezja dhe fikja	6
4	Lidhja	7
	Lidhja me Wi-Fi (punim me valë)	7
5	Punimi i dritës	10
	Çiftimi me Ambilight TV	10
	Ndjekja e muzikës	10
	Drita sipas gjendjes emocionale	11
	Rregullimi i ndriçimit	11
	Drita LED e fikur	12
	Përmbledhje	12
6	Luajtja	13
	Luajtja nga pajisjet me Bluetooth	13
	Kontrolli i luajtjes	13
	Dëgjimi i një pajisjeje të jashtme	13
	Dëgjimi i Spotify	13
	Përditësimi i firmuerit	14
7	Informacione për produktin	15

1 E rëndësishme

Siguria

Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin mbrapa ose poshtë pajisjes.
- Boksi nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vini asnjë burim rreziku mbi boks (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anembanë boksit për ajrim.
- Ju lutemi përdoreni boks në mënyrë të sigurt në ambient me temperaturë ndërmjet 0°C dhe 45°C.
- Përdorni vetëm pjesët dhe aksesoret që janë specifikuar nga prodhuesi.




Paralajmërim

- Mos e hiqni asnjëherë kasën e këtij boksi.
- Mos lubrifikoni asnjëherë asnjë pjesë të këtij boksi.
- Vendoseni këtë boks mbi një sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë boks mbi pajisje të tjera elektronike.
- Përdoreni këtë boks vetëm brenda. Mbajeni këtë boks larg nga uji, lagështia dhe nga objektet e mbushura me lëngje.
- Mbajeni boks larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria ndërrohet me një tip të gabuar.

Për pajisje Wi-Fi 5G

Pajisja për operim në bandën 5150–5350 MHz është vetëm për përdorim të brendshëm, për të pakësuar interferencat e mundshme të dëmshme ndaj sistemeve satelitore celulare.



Ndihmë dhe mbështetje

Për ndihmë të mëtejshme online, vizitoni www.philips.com/support:

- për të shkarkuar manualin e përdorimit dhe udhëzuesin e shkurtër
- për të parë tutoriale me video (vetëm për disa modele të caktuara)
- për t'iu përgjigjur pyetjeve të bëra shpesh (FAQ-të)
- për të na dërguar pyetje me email
- për të biseduar me përfaqësuesit tanë të suportit

Ndiqui udhëzimet në faqen e internetit për të zgjedhur gjuhën tuaj, dhe më pas vendosni numrin e modelit të produktit. Përndryshe mund të kontaktoni kujdesin ndaj klientit në vendin tuaj. Para se të kontaktoni, mbani shënim numrin e modelit dhe numrin e serisë të produktit tuaj. Mund t'i gjeni këto informacione mbrapa ose poshtë produktit.

2 Boksi juaj me valë


Urime për blerjen tuaj dhe mirësevinë në Philips! Për të përfutur plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Boksi
- Kablo e energjisë
- Udhëzues i shkurtër
- Dokumenti i të dhënave të sigurisë
- Garancia mbarëbotërore

Përmbledhje për boksën



- ① 
- Shfaqni statusin.
 - Mbajeni shtypur për 3 sekonda për të hyrë në çiftim me Ambient TV.
 - Shtypeni për të zgjedhur modalitetin e dritës LED.

- ② 
- Shtypeni për të rritur ose ulur volumnin.
 - Shtypni një herë  dhe  për të rritur ndriçimin e dritës LED.
 - Shtypni një herë  dhe  për të ulur ndriçimin e dritës LED.

- ③ 
- Luani, ndaloni ose vazhdoni në luajtjen me Bluetooth/Play-Fi.
 - Shtypni një herë  dhe  për të zgjedhur ngjyrën tjetër të dritës LED.

④ Treguesi i Wi-Fi (E bardhë)

Gjendja e LED	Statusi
Pulson	Modaliteti Wi-Fi Access Point (AP)
Pulsim dy herë	Modaliteti Wi-Fi Protected Setup (WPS)
Ndezur	Lidhur / Çiftimi me sukses

- ⑤  **Butoni Wi-Fi Setup**
- Bëni konfigurimin e Wi-Fi për Play-Fi.
 - Mbani shtypur butonin për 3 sekonda për të aktivizuar modalitetin WPS.
 - Mbani shtypur butonin për 8 sekonda për të aktivizuar modalitetin AP.

- ⑥  **Për shërbim**
- Priza USB vetëm për përditësimin e softuerit të boksit. Nuk ka funksion luajtjeje.

- ⑦  **Priza AC ~**
- Lidheni me energjinë.

⑧



- Mbajeni shtypur për të aktivizuar funksionin e çiftimit ose shkëputeni pajisjen me Bluetooth të çiftuar aktualisht.

⑨



RESET

- Shtypeni menjë objekt të mprehtë për 5 sekonda për të rivendosur parametrat e fabrikës.

⑩



AUX IN

- Priza e hyrjes së audios (3.5mm) për një pajisje audio të jashtme.

⑪

Drita LED e brendshme

3 Fillimi

Lidhja e energjisë

- Boksi furnizohet me energji nga hyrja AC.
- Lidheni prizën AC IN në boks me një prizë (19V = 2.1A) duke përdorur kabllon e dhënë të energjisë.
- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë aparatit.

Gjendja e LED	Statusi
Ndizet në ngjyrë blu për 20 sekonda	Duke u përpjekur për t'u lidhur me routerin
Fikur	Lidhja e Wi-Fi është bërë me sukses
Pulson në ngjyrë të kuqe për 5 sekonda	Lidhja e Wi-Fi ka dështuar

Ndezja dhe fikja

Shkëputeni kabllon e energjisë nga priza e energjisë për ta fikur boksën.



Shënim

- Boksi do të fiket automatikisht 15 minuta pasi nuk ka veprime nga përdoruesi dhe luajtje muzike.


4 Lidhja

Lidhuni me Wi-Fi (punim me valë)


(Për versionin iOS dhe Android)

Duke e lidhur këtë aparat dhe telefonata celularë, tabletat (si iPad, iPhone, iPod touch, telefonat Android, etj.) në të njëjtin rrjet Wi-Fi, mund ta përdorni Philips Sound APP të mundësuar nga DTS Play-Fi për të kontrolluar Soundbar për të dëgjuar skedarë audio.


- 1 Lidhni telefonin ose tabletën në të njëjtin rrjet Wi-Fi, me të cilin doni të lidhni boksën me valë.
- 2 Shkarkoni dhe instaloni Philips Sound APP të mundësuar nga DTS Play-Fi në një telefon ose tabletë.




- Sigurohuni që routeri është i ndezur dhe që punon si duhet.
- 3 Mbani shtypur për 8 sekonda butonin  (Wi-Fi) që ndodhet në panelin mbrapa për të aktivizuar lidhjen e Wi-Fi.
- ↳ Prisni derisa boksë të lëshojë një ton të dytë dhe më pas lëshojeni butonin.



- 4 Prisni derisa treguesi i dritës Wi-Fi në panelin e sipërm të kalojë nga pulsime të shpejta në pulsime të ngadalta. Pulsimi i ngadalta tregon se boksë po hyn në modalitetin e konfigurimit të Wi-Fi.



- 5 Hapni Philips Sound APP të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ndiqni udhëzimet në aplikacion për ta lidhur këtë produkt me rrjetin Wi-Fi.



Vetëm për versionin iOS

Rrjeti Wi-Fi i përdorur nga iPhone duhet të kalohej automatikisht te AP e pajisjes Play-Fi dhe duhet të rihapet Philips Sound APP për të kryer konfigurimin e Wi-Fi të produktit. Shikoni hapat e mëposhtëm:


- Shkoni te Settings.
- Zgjidhni konfigurimin e Wi-Fi.




- Zgjidhni pajisjen Play-Fi në konfigurimin e Wi-Fi
- Kthehuni te Philips Sound APP për të vazhduar konfigurimin.




- 6 Pasi lidhja të jetë bërë me sukses, treguesi i dritës Wi-Fi në panelin e sipërm do të ndalojë së pulsuari dhe do të qëndrojë ndezur. Pasi ta konfiguroni këtë produkt në rrjetin tuaj Wi-Fi, mund ta kontrolloni nga cilado smartfon ose cilado tabletë në të njëjtin rrjet.



- 7 Pas lidhjes, mund ta ndryshoni emrin e pajisjes. Ka disa emra mes të cilëve mund të zgjidhni ose mund të krijoni Custom Name në fund të listës së emrave. Përndryshe, ndiqet emri standard.



- 8 Pas lidhjes, aparati mund të bëjë një përditësim të softuerit. Bëni përditësimin në softuerin më të fundit kur bëni konfigurimin për herë të parë. Përditësimi i softuerit mund të zgjatë disa minuta. Mos e shkëputni boksën, mos e fikni pajisjen ose mos u largoni nga rrjeti gjatë përditësit.



Konfigurimi i AirPlay

Përdorni AirPlay për të konfiguruar lidhjen e Wi-Fi të pajisjes iOS (iOS7 ose më të ri) dhe të Soundbar.

- 1 Pajisja iOS: Settings > Wi-Fi > zgjidhni rrjetin e shtëpisë [Play-Fi Device (xxxxxx)].
- 2 Hapni Philips Sound APP të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ndiqni udhëzimet në aplikacion për ta lidhur këtë produkt me rrjetin Wi-Fi.
 - ↳ Pasi lidhja të jetë bërë me sukses, treguesi i dritës Wi-Fi në panelin përpara do të ndalojë së pulsuar dhe do të qëndrojë ndezur. Pasi ta konfiguroni këtë produkt në rrjetin tuaj Wi-Fi, mund ta kontrolloni nga cilido smartfon ose cilado tabletë
 - ↳ në të njëjtin rrjet. Kur përdorni aplikacionin për të luajtur muzikë, në ekran do të shfaqet **PLAY-FI**.

- 3 Pas lidhjes, mund ta ndryshoni emrin e pajisjes. Ka disa emra mes të cilëve mund të zgjidhni ose mund të krijoni Custom Name në fund të listës së emrave. Përndryshe, ndiqet emri standard.

- 4 Pas lidhjes, aparati mund të bëjë një përditësim të softuerit. Bëni përditësimin në softuerin më të fundit kur bëni konfigurimin për herë të parë. Përditësimi i softuerit mund të zgjatë disa minuta. Mos e shkëputni boksën, mos e fikni pajisjen ose mos u largoni nga rrjeti gjatë përditësimit.

Shënim

- Pas lidhjes, produkti mund të bëjë një përditësim të softuerit. Përditësimi nevojitet pas konfigurimit fillestar. Pa bërë përditësimin, jo të gjitha veçoritë e produktit mund të jenë të disponueshme.
- Nëse konfigurimi për herë të parë nuk bëhet me sukses, mbani shtypur butonin Wi-Fi në boks për 8 sekonda, derisa të dëgjoni tonin e dytë dhe drita e Wi-Fi të kalojë në puls të ngadaltë. Bëni përsëri lidhjen e Wi-Fi, hapni përsëri aplikacionin dhe filloni përsëri konfigurimin.
- Nëse doni të kaloni nga një rrjet në një tjetër, duhet të konfiguroni përsëri lidhjen. Mbani shtypur butonin  (Wi-Fi) në boks për 8 sekonda për të rivendosur lidhjen e Wi-Fi.

Modaliteti WPS

Nëse routeri juaj ka Wi-Fi Protected Setup (WPS), mund ta bëni lidhjen pa pasur nevojë për fjalëkalim.

- 1 Mbani shtypur butonin Wi-Fi për 4 sekonda. Do të dëgjoni një ton dhe drita Wi-Fi do të fillojë të pulsojë dy herë.

- 2 Shtypni butonin WPS në router. Zakonisht butoni është shënuar me këtë logo WPS.



- 3 Ndiqni udhëzimet në Philips Sound APP të mundësuar nga DTS Play-Fi për të filluar çiftimin.


Shënim

- WPS nuk është një veçori standarde në të gjithë routerët. Nëse routeri juaj nuk ka WPS, atëherë përdorni Standard Wi-Fi Setup.
- Shtypni butonin  (Wi-Fi) një herë nëse doni të dilni nga modaliteti WPS. Përndryshe ai do të mbyllet automatikisht pas 2 minutash.

5 Punimi i dritës

Mund të konfiguroni dritën LED të brendshme të boksit që të ndjekë ngjyrën e Philips Ambilight TV. Ose mund të bëni që drita të shfaqë një stil ngjyrash të caktuar paraprakisht ose mund ta fikni dritën.

Shtypni vazhdimisht butonin  në boks për të aktivizuar modalitetin e dritës: 1. Punim me Ambilight, 2. Drita e gjendjes emocionale, 3. Fikur.



Çiftimi me Ambilight TV

Konfigurojini bokset që të ndjekin ngjyrat e Ambilight TV. Boksi do të zgjerojë efektin e Ambilight nga ekrani i televizorit.

Boksi mund të punojë me serinë e mëposhtme të Philips Ambilight TV:


Rajoni/Viti	Seria 2019	Seria 2020
Evropë	OLED984/OLED934 OLED854/OLED804 8804/8204	OLED935 OLED865/OLED855/ OLED805
	7504/7394/7354/ 7334/7304	9435/9235/9005 8555/8545/ 8535/8505
Paqësori Aziatik	OLED984 OLED804 7374	OLED935 OLED805 8265/8215

Shënim

- Çiftimi do të mbarojë pas 2 minutash.

- 1 Para se të filloni konfigurimin, sigurohuni që boks dhe televizori janë lidhur me të njëjtin rrjet Wi-Fi.
- 2 Aktivizoni Philips Ambilight TV. Konfigurimi i çiftimit të Ambilight TV bëhet në televizor.
- 3 Aktivizoni konfigurimin siç tregohet në Ambilight TV:

Settings > Ambilight > Ambilight extension > Ambilight+Philips Wireless Home Speakers > Configure.
- 4 Ndiqui udhëzimet e konfigurimit në televizor. Do t'ju kërkohet që të mbani shtypur butonin  në boks për të hyrë në modalitetin e çiftimit me Ambilight TV.



- 5 Kur boks hapet për çiftim, dritat LED pulsojnë në ngjyrë të verdhë.
- 6 Kur boks çiftohet me Ambilight TV, drita LED në boks do të ndjekë Ambilight TV.

Ndjekja e muzikës


Nëse nuk ka Ambilight TV të lidhur ose nëse televizori është shkëputur, drita LED në boks do të kalojë automatikisht në Follow Music gjatë luajtjes së muzikës. Mund të zgjidhni një nga stilet që ndjekin dinamikën e tingujve.

1 Për të vendosur dritën LED, shtypni butonin  në boks në Modalitetin 1 "Punim me Ambientlight".

2 Mund të zgjidhni një prej stileve të caktuara paraprakisht të ngjyrave. Për të vendosur ngjyrat, shtypni  dhe  për të zgjedhur stilin e ngjyrave që doni.

Stilet e disponueshme të Follow Music janë:

- E bardhë e ngrohtë – Ngjyrë statike standarde
- Lavë e nxehtë – Variacione të ngjyrës së kuqe
- Ujërat e thella – Variacione të ngjyrës blu
- Natyrë e gjelbër – Variacione të ngjyrës jeshile
- Portokall – Variacion i ngjyrës portokalli
- Limon – Variacion të ngjyrës së verdhë
- Lavanda – Variacione të ngjyrës lela të çelët



Drita sipas gjendjes emocionale

Modaliteti i dritës së gjendjes emocionale (modaliteti Lounge) i boksit tuaj ju jep mundësi ta ndizni dritën LED (dritë statike) me ose pa luajtje të audios.


Kështu mund ta ndriçoni dhomën me dritën LED.

1 Për të vendosur dritën LED, shtypni butonin  në boks te modaliteti 2 "drita e gjendjes emocionale".

2 Mund të zgjidhni një prej stileve të caktuara paraprakisht të ngjyrave. Për të vendosur ngjyrën, shtypni  dhe  për të zgjedhur stilin e ngjyrave që doni.

Stilet e disponueshme të dritës së gjendjes emocionale janë:

- E bardhë e ngrohtë – Ngjyrë statike standarde
- Lavë e nxehtë – Ngjyrë e kuqe statike
- Ujërat e thella – Ngjyrë blu statike
- Natyrë e gjelbër – Ngjyrë jeshile statike
- Portokall – Ngjyrë portokalli statike
- Limon – Ngjyrë e verdhë statike
- Lavanda – Ngjyrë lela e çelët statike




Shënim

- Mbajeni energjinë të lidhur në modalitetin e dritës sipas gjendjes emocionale. Rrjeti ose lidhja me Bluetooth nuk nevojitet në modalitetin e dritës sipas gjendjes emocionale.


Rregullimi i ndriçimit

Vendosni nivelin e ndriçimit të dritës LED.

- Shtypni një herë  dhe  për të rritur ndriçimin e dritës LED.



- Shtypni një herë  dhe  për të ulur ndriçimin e dritës LED.



Drita LED e fikur

Për ta fikur dritën LED, shtypni butonin  në boks te Modaliteti 3 "Off".

Përmbledhje

	Modaliteti	Ambilight TV	Gjendja e LED	Veprimi
1	Ndjekja e Ambilight TV	U çiftua	Ndiq ngjyrën e Ambilight TV	Mbajeni shtypur 3 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit.
	Ndjekja e muzikës	Nuk është çiftuar	Ndrysho sipas ritmit të audios në luajtjen e muzikës	- Shtypni butonin  &  për të zgjedhur ngjyrën. - Shtypni butonin  &  për të rritur/ulur ndriçimin.
2	Drita e gjendjes emocionale (modaliteti Lounge)		Ngjyrë statike	
3	Fikur		Fikur	

6 Luajtja

Luajtja nga pajisjet me Bluetooth

Me këtë boks mund të dëgjoni audio nga pajisja juaj me Bluetooth.

Shënim

- Sigurohuni që funksioni i Bluetooth është aktivizuar në pajisjen tuaj.
- Distanca maksimale për çiftimin e boksit dhe të pajisjes me Bluetooth është 20 metra.
- Mbajeni larg nga çdo pajisje elektronike që mund të shkaktojë interferenca.

- 1 Mbani shtypur butonin  mbrapa për 8 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit me Bluetooth.
- 2 Në pajisjen tuaj me Bluetooth, aktivizoni Bluetooth, kërkoni dhe zgjidhni "**Play-Fi Device (XXXXXX)-BT**" për të filluar lidhjen.
- 3 Zgjidhni dhe luani skedarë audio ose muzikë në pajisjen tuaj me Bluetooth.

Treguesi LED	Përshkrim
Pulson me ngadalë në ngjyrë blu	• Gati për çiftim • Duke u lidhur përsëri me pajisjen e lidhur për herë të fundit
Blu statike	Është lidhur

Shënim

- Për ta shkëputur një pajisje, mbani shtypur  për 2 sekonda derisa treguesi LED të pulsojë dy herë me shpejtësi.
- Kur e ndizni boksën, ai përpiqet gjithnjë që të lidhet përsëri me pajisjen me të cilën ishte lidhur me sukses për herë të fundit.
- Për t'i fshirë informacionet e çiftimit, mbani shtypur  për 2 sekonda derisa treguesi LED të pulsojë 3 herë me ngadalë në ngjyrë blu.


Kontrolli i luajtjes

Kur luhet muzikë

 Shtypeni për të ndaluar ose vazhduar luajtjen

 Rregullimi i volumnit

Dëgjimi i një pajisjeje të jashtme



Lidhjeni aparatin MP3 për të luajtur skedarë audio ose muzikë.

Çfarë ju duhet

- Një aparat MP3.
- Një kabllo audio 3.5mm.

- 1 Duke përdorur kabllon e audios stereo 3.5mm, lidhjeni aparatin MP3 me konektorin **AUDIO IN** në këtë produkt.
- 2 Shtypni butonat në aparatin tuaj MP3 për të zgjedhur dhe luajtur skedarë audio ose muzikë.

Dëgjimi i Spotify

Përdoreni telefonin, tabletën ose kompjuterin si telekomandë për Spotify. Shkoni në spotify.com/connect për të mësuar si.

Përditësimi i firmuerit

Për të pasur veçoritë dhe ndihmën më të mirë, përditësojeni produktin me versionin më të fundit të firmuerit.

Opsioni 1:

Përditësojeni firmuerin nëpërmjet Philips Sound APP (Settings > PS Fine Tune)

Firmueri për MCU dhe DSP mund të përditësohet në versionin më të fundit nëpërmjet Philips Sound APP të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ju lutemi shkoni në menunë **Settings** dhe zgjidhni opsionin **PS Fine Tune** për ta parë. Nëse përditësimi ka dalë, mund të shtypni ikonën Upgrade për të vazhduar automatikisht. Pasi ky produkt të jetë lidhur me Wi-Fi, ai mund të marrë përditësim të firmuerit over-the-air. Përditësojeni gjithnjë me versionin më të fundit të firmuerit për të përmirësuar performancën e këtij produkti.

Opsioni 2:

Përditësojeni firmuerin nëpërmjet USB

- 1 Kontrolloni nëse ka version më të ri të firmuerit në www.philips.com/support. Kërkoni modelin tuaj dhe klikoni "Softueri dhe drajverat (Software and drivers)".
- 2 Shkarkojeni firmuerin në një USB.
- 3 Ndiqni udhëzimet për përditësimin e firmuerit.

7 Informacione për produktin



Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar paraprakisht.

Informacione të përgjithshme

Energjia	100-240V ~, 50/60Hz
Përmasat (Gje x La x The)	115 x 212 x 116mm
Pesha (njësia kryesore)	1.79Kg

Amplifikatori

Fuqia output	40W RMS
Përgjigja e frekuencës	20-20000Hz
Raporti sinjal-zhurmë	> 70db

Bokset

Impedanca	40Hm
Energjia input	30W (woofer), 10W (tweeter)
Drajveri i boksit	1 x 3.5" woofer, 1 x 1" tweeter, 2 x radiatorë pasivë

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	4.2
Diapazoni i frekuencave	2402-2480MHz
Fuqia maksimale e transmetimit	3dBm
Profilat e pajtueshme të Bluetooth	A2DP
Rrezja e Bluetooth	rreth 20m

Rrjeti që mbështetet

Rrjeti me valë	802.11 a/b/g/n/ac
Rrezja e frekuencave të transmetuesit Wi-Fi 2.4G	2412-2472MHz
Energjia e transmetuesit Wi-Fi 2.4G	20±2dBm
Rrezja e frekuencave të transmetuesit Wi-Fi 5G	5725-5825MHz
Energjia e transmetuesit Wi-Fi 5G	12±2dBm

Konsumi i energjisë

Konsumi i energjisë	30 W
Konsumi i energjisë ne gjendje gjysme pritjeje	6 W

8 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Rrezik goditjeje elektrike. Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë.

Nëse keni probleme me përdorimin e këtij produkti, shikoni pikat e mëposhtme para se të kërkonit shërbim. Nëse ende keni problem, merrni ndihmë në www.philips.com/support.

Të përgjithshme

Nuk ndizet

- Sigurohuni që në prizën AC ka energji.
- Sigurohuni që priza AC IN e boksit është lidhur si duhet.
- Si veçori e kursimit të energjisë, boksi fiket automatikisht 15 minuta pasi është marrë sinjali se nuk ka audio ose pasi është lidhur pajisja që nuk ka audio.

Nuk ka zë

- Ngrini volumnin në këtë boks.
- Ngrini volumnin në pajisjen e lidhur.
- Në modalitetin AUDIO IN, sigurohuni që lajtja e muzikës nëpërmjet Bluetooth është ndaluar.
- Sigurohuni që pajisja me Bluetooth nuk është tepër larg.

Boksi nuk përgjigjet

- Ndizeni përsëri boksën.

Bluetooth

Cilësia e lajtjes së audios nga një pajisje e lidhur është e dobët.

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni pajisjen me boksën, ose largoni pengesat mes pajisjes dhe boksit.

Nuk e gjej dot emrin e Bluetooth të këtij aparati në pajisjen time me Bluetooth

- Sigurohuni që funksioni i Bluetooth është i aktivizuar në pajisjen tuaj me Bluetooth.
- Çiftojeni përsëri aparatin me pajisjen me Bluetooth.

Nuk e lidh dot me pajisjen time me Bluetooth

- Funksioni Bluetooth i pajisjes nuk është aktivizuar. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të mësuar se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky boks nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Ky boks është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth.

Shkëputeni dhe përpiquni përsëri.

Wi-Fi

Nuk bëhet lidhja e Wi-Fi

- Shikoni disponueshmërinë e rrjetit WLAN në router.
- Afrojeni routerin Wi-Fi me aparatin.
- Sigurohuni që fjalëkalimi është i saktë.
- Kontrolloni funksionin WLAN ose rindizeni modemën dhe routerin Wi-Fi.

Play-Fi

Nuk gjej dot në aplikacion pajisjet me Play-Fi.

- Sigurohuni që pajisja është lidhur me Wi-Fi.

Nuk luaj dot muzikë Play-Fi

- Disa shërbime rrjeti ose materiale që disponohen nëpërmjet pajisjes, mund të mos përdoren dot nëse ofruesi i shërbimit e mbyll shërbimin.
- Kur konfigurimi për herë të parë nuk bëhet me sukses, mbylleni Philips Sound APP të mundësuar nga DTS Play-Fi. Hapeni përsëri aplikacionin.
- Nëse boksi vendoset si Çift Stereo ose tingull Surround, ai duhet të shkëputet nga aplikacioni para se të përdoret veçmas.

9 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim në pajisje, që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesve për ta përdorur produktin.

Pajtueshmëria



Këtu TP Vision Europe B.V. deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EC. Deklaratën e konformitetit mund ta gjeni në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi produktin do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/BE.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga direktiva evropiane 2013/56/EU, të cilat nuk mund të hidhen bashkë me mbetjet e zakonshme.

Informohuni në lidhje me sistemin vendës për mbledhjen e produkteve elektrike dhe elektronike, si edhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos i hidhni produktet dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr.

Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin të lehtë për t'u ndarë në tre materiale: karton (kutia), shkumë polisteroli (amortizatori) dhe polietilen (qeset, fleta e shkumës mbrojtëse). Sistemi përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi të respektoni rregulloret vendëse në lidhje me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Deklarata FCC (vetëm SHBA dhe Kanada)

Kjo pajisje i përmbahet pjesës 15 të rregullave FCC. Operimi është subjekt i dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme, dhe (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë operim të padëshiruar.



Paralajmërim

- Ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.



Shënim

- Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje dixhitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC.

Këto limite janë caktuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient rezidencial. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë e cila mund të përcaktohet duke e ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të përpiqet ta ndreqë interferencën nëpërmjet një ose më shumë prej masave të mëposhtme: (1) Ndryshoni orientimin ose lëvizeni antenën. (2) Largoni distancën mes pajisjes dhe marrësit. (3) Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi. (4) Konsultohuni me shitësin ose me një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë.

Deklarata e paralajmërimit për RF

Pajisja është vlerësuar se i përmbush kërkesat e përgjithshme për ekspozimin RF. Pajisja mund të përdoret pa problem në kushte ekspozimi portativ.

IC-Canada :CAN IECES-3(B)/NMB-3(B)

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës pa licencë që përputhen me RSS-në pa licencë të Kanadasë për inovacionin, shkencën dhe zhvillimin ekonomik. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme

- 1 Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë.
- 2 Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

Njoftim për markën tregtare



Për pacientët DTS, vizitoni <http://patents.dts.com>. Prodhuar me licencë nga DTS, Inc. (për kompanitë me seli në SHBA/Japoni/Tajvan) ose me licencë nga DTS Licensing Limited (për të gjitha kompanitë e tjera). DTS, Play-Fi dhe logoja DTS Play-Fi janë marka të regjistruara tregtare ose marka tregtare të DTS, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera. 2020 DTS, Inc. TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.



Logoja Wi-Fi CERTIFIED është markë certifikimi i Wi-Fi Alliance®.



Për të kontrolluar këtë boks me AirPlay 2, nevojitet iOS 11.4 ose më i ri. Përdorimi i punimeve me distinktivin Apple do të thotë se një aksesori është bërë që të punojë specifikisht me teknologjinë që tregohet në distinktiv dhe se është certifikuar nga zhvilluesi se i përmbahet standardeve të Apple për performancën.

Apple® dhe Airplay® janë marka tregtare të Apple Inc, të regjistruara në SHBA dhe në shtete të tjera.



Softueri Spotify është subjekt i licencave të palëve të treta që gjenden këtu: www.spotify.com/connect/third-party-licenses.



Fjala e markës dhe logot e Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare të zotëruara nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.



Google, Google Play dhe Chromecast built-in janë marka tregtare të Google LLC. Google Assistant nuk është i disponueshëm në disa gjuhë dhe shtete.



Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

Ju lutemi vizitoni www.philips.com/support për përditësimet dhe dokumentet më të fundit.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të regjistruara tregtare të Koninklijke Philips N.V., të cilat përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

